

SGGG Fletë informacioni për përdorueset e kontraceptiveve të kombinuara me përbërje hormonale

(Gjendja 6/2013)

Autorët: G.S. Merki-Feld, J. Bitzer, J. Seydoux, M. Birkhäuser.

Medikamentet kontraceptive hormonale e parandalojnë shtatzëninë në mënyrë shumë efektive. Këto përmbajnë dy tipa hormonesh: Estrogjen dhe një hormon të trupit të verdhë. Në kohët e sotme ka në dispozicion një numër të madh Estrogjenesh të ndryshme, si dhe hormone të trupit të verdhë. Ato mund të përdoren si tabletë, unazë vagjinale apo si flaster. Shumë rrallë ndodhin komplikime të rënda si trombozat të venave ose emboli të mushkërive si pasojë e përdorimit të këtyre medikamenteve. Disa preparate kontraceptive e kanë rrezikun më të vogël se disa të tjera (shiko më poshtë).

Për të zvogëluar rrezikun e një ngjarje të tillë, mjeku do iu pyes gjerësisht nëse faktorizoheni nga rreziku. Rrezikshmëria rritet në rastet e moshës më të lartë (> 35 vjet), pirjes së duhanit, në qoftë së një anëtar i familjes ka koagulim të gjakut në enë të gjakut, peshë të lartë, yndyrat e larta në gjak, diabet, tension të lartë, migrena, sëmundje të valvuleve të zemrës, në rast se pacienti është i shtrirë për një kohë të gjatë, ose në lidhje direkt me operacione.

Në qoftë se faktorizoheni nga rreziku, mjeku duhet të qartësojë saktësisht nëse mund t'u japë një medikament kontraktiv të kombinuar.

Si përdoruese e mjeteve kontraceptive, vetë ju mund të ulni rrezikun e ndodhive trombo-embolike ose një embolie të mushkërive, nëse për shbull, ju nuk pini duhan dhe e mbani peshën në suaza normale. Nëse jeni përdoruese e këtyre medikamenteve, është e rekomandueshme të kontrolloheni te mjeku një herë në vit.

Mund të ndodhin efekte anësore të padëmshme (shiko poshtë) të cilat shfaqen në javët e para te përdorimit. Ato shumë herë humbin spontanisht. Në qoftë se nuk largohen mund të provoni të **ndryshoni mjekimin.**

- Preparatet kontraceptive që qëndrojnë në dispozicion në treg, dallohen shumë pak për nga përmbajtja e hormonit të trupit të verdhë (Gestagen) në këto preparate kontraceptive, në lidhje me rrezikun e lidhur të përdorimit të tyre me pasoja koagulimi. Diskutimi i këtyre dallimeve është pjesë e bisedës informative, të cilën mjeku(kja) do të bëjë me ju. Sipas njohurive aktuale preparatet me Gestagen Levonorgestrel mbartin rrezikun më të vogël.
- Lexoni informacionet që janë në përmbajtjen e paketës së ilaceve.

Efektet e rënda si pasojë e përdorimit të mjeteve kontraceptive hormonale

Me përdorimin e mjeteve mbrojtëse hormonale të cilat përmbajnë Estrogjen dhe një Gestagen ekziston rrezik i shtuar lehtë për mbylljen e enëve të gjakut, venave dhe arterieve (trombozës ose emboli). Shumë rrallë ndodh të ketë dëmtime të rënda të shëndetit, apo në disa raste edhe me vdekje. Rreziku për këtë lloj të komplikimit është më i larti në vitin e parë të përdorimit. Për tu shmangur nga komplikimet e mbylljeve të enëve të gjakut, është e rëndësishme të **evidentohen sa më parë** në raste të simptomave të dyshimta të konsultohesh menjëherë me mjekun. Ju lutemi informohuni për simptomat e më poshtme. Nëse do të keni njërin nga simptomat e mëposhtme konsultoni menjëherë me mjekun.

Simptomat tipike për mbylljen e damarëve të venave dhe arterieve:

- **Trombozë e thellë e venave**
Ënjteja e njëres pjesë të këmbës ose përgjatë një pjese të venës, një ndjenjë e tendosur ose dhimbje në njëren këmbë edhe atëherë kur vetëm je në këmbë dhe kur ecën, mbinxehje, ose ndryshim i ngjyrës së lëkurës në atë pjesë të këmbës.
- **Emboli e mushkërive**
Përnjëherë në mënyrë të pashpjegueshme ndodh frymëmarrje e shkurtër, frymëmarrja e shpeshtë dhe frymëmarrja akute.
Përnjëherë të kaplon kolli, eventualisht me pështymë të përgjakur
Përnjëherë të kaplon një dhimbje e fortë në gjoks, dhimbja mund të shpeshtohet kur merr frymë thellë.
Paralizim i fortë, marramendje, emocion frike
Rrahje të shpeshta të zemrës dhe rrahje të parregullta zemre.
- **Infarkt në tru**
Kur papritmas nuk e ndjen një pjesë të fytyrës, humbje të fuqisë, në krahë dhe në këmbë
Kur menjëherë humb orientimin
Nuk flisni qartë ose nuk kuptoni mirë
Kur menjëherë të humb shikimi i mirë në njërin sy ose të dy
Kur menjëherë shfaqen probleme me ecjen, marramendje
Kur menjëherë të kaplon dhimbja e kokës e rëndë dhe afatgjate, për shkaqe të panjohura
Humbja e vetëdijes ose alivanosje, me ose pa ngërçe
- **Simptoma tjera të mbylljeve së damarëve mund të jenë:**
- Dhimbje të forta dhe mavijosje në krahë ose në këmbë
- Kur menjëherë shfaqen dhimbje të forta në bark

Nëse të shfaqen këto simptoma duhet ta ndalosh marrjen e terapisë kontraceptive hormonale dhe duhet të konsultohesh me mjekun

- Një shfaqje rishtas e migrenës ose dhimbje të forta të koke
- Kur menjëherë ke ankesa në frymëmarrje ose Kur menjëherë të kaplon kolli
- Dhimbje në këmbë (e ënjtur /pa ajër) nga shkaqe të panjohura
- Kur menjëherë të humb shikimi, të dëgjuarit, të folurit ose çrregullime të tjera
- Kur menjëherë ke dhimbje në pjesën e sipërme të barkut ose gjoksit, që e përfshin ose nuk e përfshin krahun
- Kur menjëherë të shfaqet marramendje, ndjeni dobësi dhe çrregullime emocionale
- Kolaps me ose pa ngërçe

Efektet anësore te pa dëmshme shpesh ndalen vetvetiu ose ndalen kur e ndërton preparatin

- Tendosje në gjoks
- Hemorragji të herëpashershme
- Ndryshime në disponim dhe në libido
- Dhimbje koke të lehtë
- Ndryshim oreksi dhe peshe